

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SYRI I BOTES - VIDEO-‘Rezerva Federale po shtrenjton dollarin’/ Eksperti Bajra: Efekti do të ndihet edhe në Shqipëri
ADRESA	https://www.syri.net/ekonomi/918031/video-rezerva-federale-po-shtrenjton-dollarin-eksperti-bajra-efekti-do-te-ndihet-edhe-ne-shqiperi/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 17:45:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 17:09:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e7a44645466ca5476be9d1fbb671767d61c9b7039b8670eb4b512dfc6082589b
TEKSTI	196c25276bf197dc86eb07eae95aee0809f17ebf99e2d15b172a6a6731395a2d
PAMJA	d4729d8a959838a4512a23b8ece02e63a647df99478ab160a4ab3487f7b7e53e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	608c86f3d6a4c11a5a90cdd08b75a83469ebf5dba393365a577216feeef2db7a
E MËPARSHMJA	c51dc319be28385b3849eda591c7bed7942cb398708d5ab57d852c80a17dace0
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/608c86f3d6a4c11a5a90cdd08b75a83469ebf5dba393365a577216feeef2db7a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**LAJMI I FUNDIT****LIVE-113 ditë protestë/ Qytetarët para Kryeministrit, kërkojnë dorëheqjen e Ramës****më të lexuarat**Pse bankat evropiane po e heqin arin e
tyre nga SHBA-ja?Mali i Zi dyfishon pagat duke nisur nga
janari, Edi Rama dyfishon çmimet**VIDEO-‘Rezerva Federale po shtrenjton
dollarin’/ Eksperti Bajra: Efekti do të
ndihet edhe në Shqipëri**

19:09, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Vendimet e Rezervës Federale Amerikane (FED) për normat e interesit ndikojnë drejtpërdrejt në vlerën e dollarit dhe, përmes tij, në ekonominë e vendeve të tjera.

Kështu u shpreh eksperti i tregjeve ndërkombëtare nga Londra, Emanuel Bajra, i ftuar në emisionin ‘SYRI I BOTËS’ me Dori Dakën në SYRI TV.

Sipas Bajrës, dollari vijon të jetë një komponent kyç i ekonomisë globale dhe ndryshimet në politikën monetare të FED-it reflektohen shpejt edhe në monedhat e tjera.

‘Sa e ka çmimin dollari në syrin e FED-it, bankës qendrore amerikane, do të reflektojë në mënyrë direkte tek ne, për shkak se ne varem nga krediti dhe zinxhiri ynë ekonomik ka varësi nga shkëmbimet në dollar’, deklaroi Bajra.

Ai theksoi se ndikimi i dollarit është veçanërisht i rëndësishëm për tregtinë ndërkombëtare, duke marrë si shembull naftën dhe produktet e tjera që tregtohen në tregjet globale.

Bajra u ndal edhe te vendimet e fundit të FED-it për normat e interesit, duke argumentuar se një rritje e tyre përcjell sinjalin e një dollari më të shtrenjtë dhe më të fuqishëm.

‘Ne në fakt e kemi diskutuar shpesh edhe këtë temë, për shkak se është e rëndësishme. Unë ju aplaudoj juve që merrni një iniciativë të tillë për ta ridiskutuar dhe për ta shtjelluar edhe më thellësisht, sepse është një faktor, një komponent shumë i rëndësishëm i gjithë ekonomisë globale, veçanërisht për ekonominë që janë në rritje, si ekonomia shqiptare, ekonomia e Kosovës, ekonomia e rajonit e të tjera.

Pra. FED-i është një bankë qendrore. sikurse Banka Qendrore e Shqipërisë. por

VIDEO-‘Rezerva Federale po shtrenjton
dollarin’/ Eksperti Bajra: Efekti do të
ndihet edhe në ShqipëriTarifa e re për krijimin e rezervës së
sigurisë rrezikon të rrisë çmimet e naftësShpopullimi masiv/ Ikin të rinjtë,
dyfishohet numri i pensionistëve të
punësuarBB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e
nevojshëm për ujë e kanalizime, por nuk
ka ujë

ka një modalitet krejt tjetër të mënyrës se si funksionon. Ndryshe nga Banka Qendrore Evropiane, është e krijuar nga entitete private amerikane. Pra, 12 njësitë që i ka në të gjithë Amerikën si institucion, të 12 njësitë i kanë aksionarë bankat komerciale. Edhe ato vijnë tek FED-i në Neë York dhe i marrin vendimet monetare.

Tashmë këto vendime monetare përbëjnë këtë komponentën më të rëndësishme që na afekton neve: çmimin e dollarit. Sa e ka çmimin dollari në syrin e FED-it, bankës qendrore amerikane, do të reflektojë në mënyrë direkte tek ne, për shkak se ne varem nga krediti dhe zinxhiri ynë ekonomik ka varësi nga shkëmbimet në dollar.

Nafta, për shembull, vetëm naftën nëse e marrim, edhe nëse je eksportues i naftës, ti prapëseprapë varësinë e ke në dollar, sepse në minutën, sekondën që një derivat i naftës, një njësi, një komponent, një vlerë, një ushqim ose një prodhim që bëhet, që eksportohet jashtë ose që importohet, duhet detyrimit të kalojë nga dollari. Nuk ka formë tjetër, nuk ka model tjetër, nuk ka valutë tjetër që e zëvendëson dollarin tani për tani.

Kjo pse ka ndodhur, Dori? Ka ndodhur për shkak se, natyrisht, nuk duhet të futemi në thellësime historike, por pas vitit 1945 Britania e Madhe ishte me fundin e saj, me stërlinën e saj ishte ajo denominatori kryesor i botës, si rezervë valutore e botës, por u spostua dhe iniciativën natyrisht e mori Amerika, sepse Amerika ishte në gjendje shumë më të mirë ekonomike sesa Evropa.

Evropa ishte e shkatërruar. Edhe Amerika, për ta zënë hapin me fundin e stërlinës angleze, u fut dhe i dha kredi multimiliarda Evropës për t'u rindërtuar. Që nga ajo kohë, kjo levë është rritur, është ekspanduar, është zgjeruar, është thelluar në gjithë tregun global.

Se mos harrojmë, Dori, në vitin '45 deri në vitin '60 Evropa është rritur në mënyrë eksponenciale ekonomikisht, se ka pasur kërkesa të mëdha për ndërtim të ri, kërkesa të mëdha për shërbime të reja e të tjera.

Pra, sot jemi në një ekosistem ku, në momentin kur FED-i vendos ta ndryshojë normën e interesit, siç e ndryshoi tashmë me rritje prej 3.75 në 4, kjo çon dy sinjale.

E para, çon sinjalin e shtrenjtësisë së dollarit. Tashmë të gjitha valutat e tjera do ta ndiejnë këtë efekt brenda ditëve: efektin e shtrëngimit, efektin e daljes nga tregu të valutave më të dobëta dhe fuqizimin e dollarit.

Për këtë arsye presidenti Trump ka qenë kundër, kategorikisht kundër.', u shpreh Emanuel Bajra në SYRI TV.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SYRI TV/ Moody's paralajmëron për pronat në Shqipëri, çmimet e banesave rrezikojnë stabilitetin financiar



Kostoja e një foshnje në Shqipëri, sa 66% e pagës mesatare vjetore, e dyta më e shtrenjtë në Europë



Këmbimi valutor 20 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera

Thellohet kriza e prodhimit në Shqipëri/ Fasoni në rënie të pandalshme, zbrit në grupin e dytë

Këmbimi valutor 20 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera

'Taksë e fshehtë' mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria


TË NGJASHME



Çfarë po ndodh me monedhat e huaja? Ja sa shitet dhe blihet euro dhe dollari



BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por nuk ka ujë



Mali i Zi dyfishon pagat duke nisur nga janari, Edi Rama dyfishon çmimet



Pse bankat evropiane po e heqin arin e tyre nga SHBA-ja?

Këmbimi valutor sot - Ja me sa blihen
e shiten dollari dhe euro, si luhaten
monedhat e tjera

Gati gjysma e shqiptarëve kanë
vështirësi të mbyllin muajin

'Taksë e fshehtë' mbi naftën për
rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi,
e pranon dhe qeveria

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.